



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË/A:	15/09/2026
REFERENC-Ë :	Zyrt. 04 / 343/
PËR/ZA/TO :	Zyrës së Informimit në Kuvendin Komunal, Zyrës së pranimit dhe Arkivës pranë KK-së, SIA-së, Radio Gjakovës
KOPJE :	Shkolla e Mesme e Lartë Teknike “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, Arkivit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë
NGA/OD/FROM :	z.Hysen Brahimaj– Drejtor i Drejtorisë së Arsimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT :	Konkurs për mësimin AAPRr – Afati i Shtatorit/2026

Në bazë të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës nr.04/L-143 neni 11, 12, i dt. 13 Dhjetor 2012, Ligji për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068 neni 5 shkronja b i dt.21 Maj 2008, Rregullore (MASHT) nr.01/2017 për Planifikimin dhe Shpenzimin e të Hyrave Vetanake të Realizuara nga Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur (IAAPRr), Rregullorja për Taksa Komunale nr.01-110/04-29366, dt.30.12.2022 të Komunës së Gjakovës, Rekomandimit nga MASHT Referencë Nr.3/95 i dt. 06/03/2015, Kërkesës nga shkolla me nr. prot. 995/26 i dt.09.09.2026 SHMLT “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, shpallë :

K O N K U R S

Për regjistrimin e vijuesve (të rriturve) në Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur (AARr) në shkollën „Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, për klasët e X-ta, XI-ta dhe XII-ta :

Drejtimi : **Elektroteknikë** me profilet përkatëse:

- Energjetikë..... 32 vijues
- Informatikë 32 vijues
- Instalues elektrik 32 vijues

Drejtimi : **Makineri** me profilet përkatëse:

- Operator prodhimi 32 vijues
- Transport rrugor 32 vijues
- Automekanik 32 vijues

Drejtimi : **Ndërtimtari** me profilet përkatëse :

- Arkitekturë 32 vijues
- Ndërtimtari 32 vijues

Drejtimi : **Tekstilit** me profilin përkatës :

- Rrobaqepës..... 32 vijues

Drejtimi : **Artit Pamor** me profilin përkatës :

- Dizajni i tekstilit dhe veshjeve..... 32 vijues

REGJISTRIMI I VIJUESVE NË PROGRAMIN “Arsimi për të rritur” bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në Ligjin nr.04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve administrative nga MASHTI.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. **Dëftesa e klasëve të kryera paraprake**
2. **Çertifikata e lindjes**
3. **Pagesa.**

Shkollimi në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë është me pagesë.

Participimi bëhet në bazë të Rregullores nr. 01/2017, dt. 02.02.2017 Për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur, dhe Rregullores për Taksa, Komunale neni 01-110/04-29366, dt.30.12.2022 të Komunës së Gjakovës.

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e (IAAPRr) në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë:

1. Për regjistrim të vitit për një klasë100.00€
2. Praktika profesionale.....50.00€
3. Provimi diferencial10.00€
4. Diploma e përfundimit të shkollimit.....50.00€

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin, do t`u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në Rregullores 01/2017 të MASHT-it.

Kandidatët të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht ti nënshtrohen provimeve diferenciale. Dhënja e provimeve diferenciale bëhet në afat të veçantë nga afati për dhënjen e provimeve të klasës për vitin vijues. Dëftesat dhe diplomat që merrën në programin Arsimit dhe Aftësimit për të Rritur janë të barasvlefshme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Dokumentet dorëzohen në SHMLT „Nexhmedin Nixha” Gjakovë .